

"Kartele Shoqëruese e Praktikës"

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT (OST sh.a)

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues K. MINISTRAVE, Nr. Prot. 2666/1, Data 20.05.19,

Shkurtimi i lëndës Vendim = 322 dt 15.05.19.

(3F)

Për trajtim nga:	DOT: Azna Kallan t'Ullas Për slyer: Drejtorët e Drejtorisë Drejtorëve të Sektorëve
(struktura të tjera të ngarkuara)	
Me porosi:	

Afati: Normal (7 ditë) | Prioritet (3 ditë) | Urgjent (brenda ditës) | Pa afat/për dijeni Tjetër ___ ditë

Nr. 3410 Prot. Datë 21.05.19, Nënshkrimi: _____

Marrë në dorëzim: _____, Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____, _____, _____,

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____, Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____, _____, _____,

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: _____, Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim Specialistit: _____, _____, _____,

Me porosinë: _____

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____, Specialisti
 Trajtimi i materialit pranuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike
 Trajtimi i materialit miratuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike
 Trajtimi i materialit miratuar më: _____, Eprori në shkallë hierarkike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



V E N D I M

Nr. 322, datë 15.5.2019

P Ë R

**KRIJIMIN DHE PËRCAKTIMIN E FORMËS LIGJORE
DHE TË STRUKTURËS SË PRONËSISË SË KAPITALIT
TË OPERATORIT TË TREGUT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1/1, të nenit 57, të ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e Operatorit të Tregut (Bursa Shqiptare e Energjisë), si struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e tregut të organizuar ndërmjet platformës së tregut, i cili do të operojë në fushën e shkëmbimit të energjisë elektrike në Shqipëri, në formën e një shoqërie aksionare, të ndarë financiarisht dhe ligjërish nga “Operatori i Sistemit të Transmetimit”, sh.a., (më poshtë referuar si “OST”).
2. Kapitali fillestar i regjistruar i Operatorit të Tregut nuk do të jetë më pak se 250 000 000 (dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë, e cila do të financohet nga OST-ja.
3. Në rastin kur persona të tjerë juridikë do të bëhen pjesë në strukturën e pronësisë së kapitalit të Operatorit të Tregut, me anën e një procedure konkurrimi, në sipas pikës 1/2, të nenit 57, të ligjit nr.43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, këto subjekte mund të jenë, si më poshtë vijon:
 - a) Operatorë të tjerë të sistemit të transmetimit (më poshtë referuar si “TSO”) të themeluar dhe që operojnë në Bashkimin Evropian ose në vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë;
 - b) Operatorë me aktivitet ndërkombëtar, me eksperiencë në operimin/menaxhimin e tregjeve të shkëmbimit të energjisë elektrike të themeluar dhe që operojnë në Bashkimin Evropian ose në vendet anëtare

të Komunitetit të Energjisë, në përputhje me rregullat dhe modelin e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri (më poshtë referuar si “Operatorët me Eksperiencë Ndërkombëtare” ose “OEN”);

c) Subjekte pjesëmarrëse në tregun e energjisë elektrike, me përvojë në tregtimin e energjisë elektrike në Bashkimin Evropian ose në vendet anëtare të Komunitetit të Energjisë (më poshtë referuar si “Pjesëmarrësit e tregut të energjisë” ose “PTE”);

ç) Institucione financiare ndërkombëtare (më poshtë referuar si “IFN”).

4. Struktura e aksionarëve që zotërojnë kapitalin, sipas pikës 3, të këtij vendimi, do të jetë:

a) TSO-ja, duke përfshirë këtu edhe OST, sh.a.-në, do të kenë të paktën 55,5% të kapitalit;

b) OEN-të mund të kenë jo më shumë se 24,5 % të kapitalit;

c) PTE-të mund të kenë jo më shumë se 10 % të kapitalit;

ç) IFN-të mund të kenë jo më shumë se 10 % të kapitalit.

5. Ngarkohet OST-ja për kryerjen e procedurave ligjore pranë organeve kompetente për regjistrimin e Operatorit të Tregut.

6. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit, sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

Z È V E N D È S K R Y E M I N I S T R I

ERION BRAÇE

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

Në mungesë dhe me porosi

HANTIN BONATI

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ

NR.PROT. 2666/1
DATË 20.5. 2019

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

